

UNË NUK JAM KUJDESTAR I FESË, AS PASQYRA E SAJ!



PARIMET MODERNE TË MËSIMDHËNIES NË EDUKIMIN E PROFETIT MUHAMED (A.S)



XHAMITË E SHKODRËS DHE FUNDI I TYRE GJATË PERIUDHËS SË SUNDIMIT TË EGËR KOMUNIST

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 22 - Nr. 2 (252), Shkurt, 2024

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990



ISLAMI I VËRTETË ËSHTË DITURI, PUNË DHE MORAL FISNIK

NË KRAH TË BESIMIT NË ALLAH, ADHURIMIT DHE DEVOTSHMËRISË NDAJ TIJ!

DERA E SULTAN ABDULMEXHIDIT | XHAMIA E PEJGAMBERIT (A.S) | MEDINE

VAKËFET E SHKODRËS NUK JANË FUSHË PËR AKROBATË TË POLITIKËS, A FUTAHUNDËS PROVINCE!”

MYFTIU I SHKODRËS MORI PJESË NË PRITJEN E AMBASADËS SË KUVAJTIT

“ISRAJA DHE MIRAXHI” TRIBUNË FETARE ME XHAMITË E ZONËS SË BUSHATIT

NATA E MADHE E ISRASË DHE MIRAXHIT, SIMBOL I RIMËKËMBJES SË MADHE ISLAME!

PROMOVOHET LIBRI ME DY VËLLIME “KËSHILLA MINBERI”

MYFTIU SYTARI LIGJËROI NË DISA XHAMI SHQIPTARE NË ZVICËR



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

VAKËFET E SHKODRËS NUK JANË FUSHË PËR AKROBATË TË POLITIKËS, A FUTAHUNDËS PROVINCE!"

Ndër shekuj, muslimanët shkodranë, të vetëdijshëm për rëndësinë dhe peshën e vakëfit në mbarëvajtjen e jetës fetare, sociale e kulturore të shoqërisë, nuk hezituan të dhuronin në këtë drejtim, duke u dëshmuar për bamirësi e solidaritet!

Akoma sot, përmendet në Shkodër: Vakëfi i Shaban efendisë, xhamia e Fushë Çelës (lexo: Çel Zylyftari), fusha e Tabakut, vakfi i Zdrales, çinarët, puset e hajrateve, e shumë e shumë vakfe të ngjashme në çdo lagje e fshat.

Periudha e ndarjes së detyruar nga Hilafeti i lavdishëm Osman, solli edhe "mëvetësinë" e dhimbshme të Komunitetit Mysliman dhe përpjekjet për organizim, në një realitet të vështirë, me mungesa të theksuara në kuadro e strategji, si dhe nga rreziku i përhershëm i ndikimeve të ndryshme, në kushtet e izolimit!?

Izolimet, përherë krijojnë situata plot turbulenca, humbje ekuilibri dhe devijime, që shpien deri në humbjen e dinjitetit dhe tjetërsimin e boshtit, siç ka rrezik të ndodhë përherë në periudha tranzicionesh!?

Komunizmi i dha një goditje selektive pronave të komuniteteve fetare, duke prishur e shkatërruar xhamitë e medresetë kryesore, duke konfiskuar bibliotekat e shquara muslimane të Shkodrës dhe duke mos lënë, qoftë edhe një xhami të vetme në këmbë, me përjashtim të Xhamisë së Plumbit dhe një aneksi të xhamisë së vjetër të Tophanës, që shërbeu si dyqan vajguri. (Kam qenë i vogël në moshë, kur rrija në radhë me një bidon alumini, për të blerë vajguri në atë vend!).

Pas vitit 1990, nisi rimëkëmbja e Myftinisë Shkodër, ku ndër përparësitë e organizimit ishte edhe rikthimi i vakëfeve të shenjta. Po si?

Shumë e shumë dosje, akoma sot, sillen zyrave të shtetit, duke mbajtur peng kthimin e tyre final tek i zoti, duke mbajtur peng zhvillimin dhe njëkohësisht, duke dëshmuar dështimin e qeverive të këtyre tre dekadave në kapërcimin me sukses të këtij hendeku të shëmtuar në marrëdhënie me pronat e Myftinisë Shkodër.

Sa e sa premtime, por edhe sa e sa teka e kapriço të papërgjegjshme të drejtuesve të ndryshëm, emrat e të cilëve sot janë harruar, ndonëse në arkivat tonë, janë rrethuar me njolla turpi e mosrespekti, për arrogancën e dëshmuar në hak të një të drejte legjitime, të grabitur, pastaj mohuar e pastaj nëpërkëmbur në hak të muslimanëve shkodranë dhe institucionit të Myftinisë së tyre!

Përtej insinuatave të dallkaukëve misionarë të rrugës, gjatë këtyre dekadave, vakëfet e kthyera janë administruar me përgjegjësi dhe brenda politikës së të mundurës, në kushtet e gati-gati mbijetesës! Nuk janë shitur, as tjetërsuar vakëfet e Shkodrës! Kush thotë të kundërtën, gënjen!

Nuk e ka humbur vakëfi e xhamia e jonë pozitën dhe rolin e saj në shoqëri, as në aspektin social, as në atë kulturor, as bamirës e më gjerë, siç lexojmë andej-këndej në tribuna të dëshpëruara!?

Duhet vlerësuar në kufijtë e kontekseteve të kohës dhe politikës së ditës, mundi dhe kontributi i myftilerëve të nderuar të kësaj periudhe: H. Faik Hoxha, H. Bashkim Bajraktari, Imam Ndriçim Sulejmani, z. Ermal Nurja për çdo përpjekje në këtë drejtim.

Janë kthyer shumë e shumë vakëfe, pjesa më e madhe e të cilëve janë mbajtur peng deri vonë, duke mos u legalizuar ndërtimet e reja mbi të njëjtat vakfe shekullore, duke u nëpërkëmbur procesi i pajisjes me certifikatë të rregullt pronësie, por edhe duke u legalizuar ndërtime pa leje mbi vakfet tona, në mënyrë flagrante e ilegjitime dhe me mbështetje politike..!?

Vetëm në harkun e vitit të fundit, falë përpjekjeve dhe takimeve të shumta të zhvilluara me faktorë të ndryshëm, kemi arritur të certifikojmë vakëfe të vjetra e shekullore me vlerë për ne, si: vakfi i rrethuar i Fushë Çelës, Kompleksi i Medresesë së djemve, xhamia e Rusit, por jo vetëm!

Më herët kemi arritur të certifikojmë pronat e shenjta në Zogaj, te fusha e Tabakut, në Zdralej dhe shumë xhami e vakfe në fshat.

Vakfet e Shkodrës janë vakfet e Myftinisë Shkodër dhe është përgjegjësi e Myftinisë Shkodër me organizmat e saj trajtimi, vendosja e strategjive, zhvillimi, shfrytëzimi, gjallërimi dhe përfitimi prej tyre brez pas brezi, për të mirën e Thirrjes Islame, aktivitetit bamirës, atij social e më gjerë!

Përshpërimat dhe grricjet që vijnë nga majtas-djathtas, nga qoshke lokalesh e zyra të hutuarish, në drejtim të vakfeve tona, janë kakofoni dhe zhurma akustike që i kthejmë mbrapsht, duke i shikuar prej lart poshtë, me habi dhe përbuzje (kur, duhet patjetër të shihen në atë mënyrë!)..!?

Përshpërimat dhe grricjet që vijnë nga majtas-djathtas, nga qoshke lokalesh e zyra të hutuarish, në drejtim të vakfeve tona, janë kakofoni dhe zhurma akustike që i kthejmë mbrapsht, duke i shikuar prej lart poshtë, me habi dhe përbuzje (kur, duhet patjetër të shihen në atë mënyrë!)..!?

Detyra e Myftiut të Shkodrës, administratorit, menaxherëve, stafit të brendshëm, imamëve dhe njerëzve të përgjegjshëm, është të lobojnë maksimalisht e të përpiqen në mënyrë të organizuar për zhvillimin e mëtejshëm të vakëfeve të Shkodrës, që nuk kanë qenë e nuk mund të jenë kurrë "mall vakuf" në ambiciet e dallkaukëve dhe njerëzve të vegjël, sado të afërt a të largët që të jenë!

Fuqizimi i vakëfit dhe zhvillimi i tij i jep jetë aktivitetit dhe krijon mundësi të daljes nga bataku mjeran i "mëvetësisë" së varur dhe të mbajtur peng!

Vakëfet janë damarë jete, që e kemi për borxh shpirtnor, moral e qytetar t'i mbrojmë me shumë fanatizëm dhe intolerancë, jo "vakuf" misionarësh e lajkatarësh primitivë të provincës e përtej!

UNË NUK JAM KUJDESTAR I FESË, AS PASQYRA E SAJ!

Unë nuk jam mbikëqyrës i fesë, as pasqyra e saj! Kjo fé dhe kjo Thirrje qëndrojnë mbi mua dhe përtej meje! Unë fisnikërohem duke i shërbyer me sa të kem mundësi, forcë e jetë

Nuk përkufizohet Islami në veprimet e mia, as në sjelljen time, as në dijen a preferencat e mia intelektuale! Nëse ndonjëherë keni kuptuar të kundërtën e saj në fjalët a shkrimet e mia, ju kërkoj shumë ndjesë!

Islami është feja e Zotit, dini i Allahut, paketa më e sigurt për udhëzimin e njeriut në jetë, ndërsa unë e ju jemi njerëz dhe, njeriu është i mangët, i gabueshëm!

Për këtë, tek ne në Islam, feja konsiderohet rregullator i jetës, ndërsa besimtari ftohet të jetë shembull i saj, pasqyrim i vërtetësive të saj në moral e sjellje, në mendime e ndjenja, në dituri e përparim dhe përtej tyre, duke u disiplinuar me rregullat e saj, duke respektuar vijëzimet e rrugës së gjatë...

Fakti që të dërguarit e Allahut ishin njerëz, pasqyron më së miri, se feja ka një rol të pazëvendësueshëm në edukimin dhe disiplinimin e jetës së njeriut, sipas hartës më të saktë të edukimit dhe udhëzimit të saj, që Zoti shpalli për njerëzimin, për të mos e lënë atë në dorë të egos dhe kapaciteteve të ngushta, në përmasat e të cilave, e krijoi!

Por, ndodh që njeriu, për një arsye a një tjetër, të humbasë ekuilibrin, të gabojë, të hutohet, të bëjë gjynah, të bie në batakun e egoizmit, mendjemadhësisë, vetëkënaqësisë e arrogancës. Në këtë rast, assesi nuk duhet marrë për bazë e t'i llogaritet fatura e lëkundjeve të tij, fesë!? Nëse reflekton dhe pendohet, Zoti e faltë dhe e mëshiroftë. Nëse jo, Zoti e shëroftë, se është i sëmurë rëndë! Ndërsa feja, feja mbetet qelibar, e paprekur, e papërlyer!

Feja qëndron mbi njeriun! Njeriu që disiplinohet me fenë dhe dëshmohet si "Kur'an i gjallë", që lëviz mbi tokë, dëshmon mrekullinë e saj në jetën tonë. Por, as ky lloj njeriu, as ndonjë tjetër, kurrsesi nuk ka, as mund të ketë të drejtë ta konsiderojë veten si mbikëqyrës i fesë, i Thirrjes Islame, i institucioneve fetare e përtej tyre! Njeriu është kalimtar, feja jo, nuk vdes as shuhet me njërin a tjetrin, as shuhet me dhunimin, cënimin, shpifjen a trillimin, luftën a përpjekjet kundër saj!

Unë nuk jam mbikëqyrës i fesë, as pasqyra e saj! Kjo fé dhe kjo Thirrje qëndrojnë mbi mua dhe përtej meje! Unë fisnikërohem duke i shërbyer me sa të kem mundësi, forcë e jetë!

Ato bëjnë edhe pa mua, njësoj si çdo institucion ku mund të kem punuar, a aktualisht ku vazhdoj të shërbej! Kjo është një mesele, që vlen t'ia kujtojmë shpesh vetes, më së paku!

Allahume na bëj çelësa të së mirës, drynj të së keqes dhe na mbro nga intrigat e kësaj bote kalimtare dhe bataku i së keqes, injorancës, mediokritetit!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Shkodër, 7 shkurt 2024





H.T. Shejkh Ahmed Keftaro
(1915-2004)

"Islamit i mungon prezantimi, në tërësinë dhe thelbin e tij, në mënyrë pozitive! Allahu e ka garantuar Islamin si një program për lumturinë e njeriut nën hijen e lirisë së besimit: "Nuk ka dhunë në fé". Islami e bëri diturinë obligim për çdo njeri!

Islami ia obligon muslimanit kërkimin e dijes, madje të jetë dijetar, që mëson edhe të tjerët.

Historia na e vërteton këtë. Kudo ku ka hyrë Islami, në çdo vend, ai vend është kthyer nga gjendja e injorancës, prapambetjes, miteve e iluzioneve, drejt gradës së muslimanit dijetar!

Gjatë periudhës së sundimit islam, nga Andaluzia në Indi, nuk kishte vend të përparuar e vend të prapambetur! Civilizimi dhe qytetërimi islam i përfshiu të gjithë!

Përshtati në shqip nga arabishtja:
Muhamed Bardhyl Sytari

PARIMET MODERNE TË MËSIMDHËNIES NË EDUKIMIN E PROFETIT MUHAMED (A.S)



Besim Barbullushi
Imam, xhamia Rus

(Vijon nga numri i kaluar)

PARIMI I QARTËSISË

Një nga parimet e domosdoshme të mësimdhënies është qartësia dhe dallueshmëria e saj. Sipas parimit të qartësisë, mësuesi duhet të përdorë një gjuhë të qartë, të kuptueshme, kuptimplote dhe koncize të përshtatshme për adresuesin gjatë shpjegimit të temës. Nuk duhet të komplikojë të kuptuarit e bashkëbiseduesit me shprehje të panevojshme dhe komplekse. Konceptet dhe strukturat e fjalive të përdorura duhet të jenë sipas nivelit të edukimit, kulturës dhe inteligjencës së adresuesit.

Fjalimet e Profetit janë të qartë, gjuha e tij është e thjeshtë dhe e kuptueshme dhe stili i tij është mjaft i rrjedhshëm. Ai ishte një orator i suksesshëm që dëgjon bashkëbiseduesin e tij, nuk i mërzit njerëzit me fjalimet e tij dhe nuk i ndërlikon fjalët e tij me zbukurime të panevojshme.

Ai zakonisht fliste në një mënyrë për të shprehur shumë kuptime me pak fjalë, kështu që tha për vete: "Unë u dërgova me xhevamiu'l-kelim (duke folur më pak dhe shkurt)"[1] Nëna jonë Aishja (r.a) e përmbledh në këtë mënyrë mënyrën e të folurit te Pejgamberit (a.s): "Kur ai fliste, fjalët e tij ishin aq të shkurta saqë nëse dikush kishte dëshirë mund edhe t'i numëronte."[2] Në një transmetim tjetër, Hz. Aishja (r.a) përmend se fjalimi i të Dërguarit të Allahut ishte me ndërprerje (fjalë për fjalë) dhe se kushdo që e dëgjonte mund ta kuptonte lehtësisht.[3] I Dërguari i Allahut gjithashtu thekson se fjalët e zbukuruara, të ekzagjeruara dhe të praruara që janë të pëlqyeshme për njerëzit duhet të shmangen.[4]

Këtë qartësi (pastërtia) në fjalimin e Profetit tonë (a.s), Hz. Ebu Bekri (r.a) e pëlqente shumë dhe e admironte tej mase. Një ditë ai ia shprehu këtë atij dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Nuk kam hasur në njeri që flet më mirë se ju dhe është më i ditur se ju!" Për këtë, i Dërguari i Allahut tha: "Zoti im më edukoi dhe më rriti në tokën e Beni Sa'dit."[5]

Qartësia ndahet në dy pjesë: qartësi ndijore e bazuar në shqisat dhe qartësi e brendshme e bazuar në imagjinatën. Në përputhje me parimin e qartësisë shqisore, edukatori duhet të përdorë materiale që tërheqin organe të ndryshme shqisore. Kështu, një mesazh do t'u dërgohet të gjithë studentëve me lloje të ndryshme inteligjence. Sa më shumë të trajtohen shqisat në metodat dhe teknikat e përdorura në procesin e mësimdhënies, aq më e madhe është qartësia. Sipas parimit të hapjes së brendshme, mësuesi duhet të përdorë teknika si përshkrimi, raportimi, formësimi, shpjegimi dhe krahasimi i shembujve dhe të pasurojë shprehjen e tij me gjeste dhe shprehje të fytyrës.[6]

Metodat dhe teknikat e ndryshme të përdorura në sunetin profetik janë në thelb një kërkesë e parimit të qartësisë. Shprehja e Profetit me numra, parapëlqimi i tij për metodën e përmbledhjes dhe përdorimi i shpjegimeve dhe krahasimeve të bazuara në marrëdhëniet shkak-pasojë janë aplikime që tërheqin inteligjencën matematikore.

Është e rëndësishme për dëgjuesit me aftësi të lartë të inteligjencës verbale që ai të përdorë shëmbëlltyra, krahasime dhe metafora në rrëfimin e tij dhe të zgjojë vëmendjen e njerëzve me oratorinë e tij efektive. Për individët me inteligjencë vizuale, të cilët janë të prirë për të mësuar duke imagjinuar ose formësuar në mendjet e tyre, vlen të përmendet se i Dërguari i Allahut ka përdorur objekte, ka preferuar mësimin përmes ilustrimeve dhe ka përdorur shpesh metodat e përngjasimit, paraqitjes dhe përshkrimit që të përfitojnë nga imagjinata e këtyre individëve.[7]

Kjo metodë e përdorur në sunetin profetik dhe të gjitha teknikat sigurojnë që mesazhi t'i përcillet audiencës në një mënyrë të kuptueshme dhe që ajo që tregohet të fitojë qartësi në mendjet e tyre. Me pak fjalë, aplikacione të tilla që mbështesin shprehjen e qartë dhe të kuptueshme janë të domosdoshme në arsim.

PARIMI I VEPRIMTARISË (PJESËMARRJA AKTIVE)

Për të shpjeguar qartë parimin e veprimtarisë, para të mësuarit aktiv, do të ishte e përshtatshme të prekej e kundërta e tij, të mësuarit pasiv. Të mësuarit pasiv është një mësim në të cilin mësimet e reja nuk krahasohen me njohuritë e mëparshme dhe nuk zbatohen analizat dhe sintezat e nevojshme për të siguruar lidhjen ndërmjet njohurive. Shkurt, është mësim i përqendruar përmendësh dhe është i lodhshëm, edhe gjithashtu joefikas.[8]

Të mësuarit aktiv, nga ana tjetër, kërkon të qëndrosh larg memorizimit dhe të mësuarit duke kapur informacionin gjatë periudhës së mësimdhënies. Sipas parimit të veprimtarisë, nxënësi duhet të jetë i aftë të marrë pjesë në procesin mësimor me sa më shumë shqisa.

Qëndrueshmëria në mësimin e tyre sigurohet nga shkalla efektive e pjesëmarrjes së nxënësit në mësim. Për këtë arsye, nxënësit duhet të mësojnë duke bërë dhe duke përjetuar sa më shumë që të jetë e mundur. Sipas rezultateve të marra nga eksperimentet pedagogjike, përfitimet e marra si rezultat i edukimit pasiv janë mjaft sipërfaqësore dhe jo afatgjata.

Përveç kësaj, nuk e motivon studentin ashtu siç duhet. Sa më shumë informacioni të shndërrohet në veprimtari nga nxënësi aq më e gjatë do të jetë qëndrueshmëria e tij.[9]

1. Buhari, Ta'bir, 22 (H. No. 7013).
2. Buhari, Menakib, 23 (H. No. 3567).
3. Ebu Davud, Edeb, 21 (H. No. 4839).
4. Ebu Davud, Edeb, 93 (H. No. 5006).
5. İsmâil b. Muhammed el-Axhlûnî el-Xherrâhî, Keshfu'l-Hafâ, Mektebetu'l-Kudsî, KaKajrohire 1932, I, fq. 70.
6. Muhsin Hesapçıoğlu, Öğretim İlke ve Yöntemleri: Eğitim Programları ve Öğretim, Beta Basım Yayım, Stamboll 1997, fq. 146-147.
7. Për më shumë shih termin (turqisht) "Çoklu Zekâ Kuramı".
8. Veyis Güngör, Aktif Öğrenme Yöntemleri, Hollanda Türk Akademisyenler Birliği Yayınları, Amsterdam 1993, fq. 33-34.
9. Muhsin Hesapçıoğlu, Öğretim İlke ve Yöntemleri: Eğitim Programları ve Öğretim, Beta

Risitë e bëra në mësimdhënie në përputhje me parimin e veprimtarisë e sjellin mësuesin në pozicionin e vetëm menaxhues dhe administrues. Ndaj mendohet se mësimdhënia duhet të jetë me në qendër nxënësin. Në mësimdhënie, që është një proces efektiv, nxënësit duhet të jenë gjithmonë aktivë dhe nxënësit t'i jepet mundësia të flasë dhe të bëjë pyetje në orën e mësimit. Sepse vetëm kështu zbulohen të metat dhe talentet e nxënësve.[10]


Shohim se në edukimin e të Dërguarit të Allahut, gjuha e "hâl"-it (gjendjes) është më e rëndësishme se gjuha e "kâl"-it (thënies). Ky qëndrim bëri ndikimin e vet në edukimin e sahabëve, të cilët e morën atë si model në çdo aspekt. Sidomos në mësimin që kërkon imitim dhe praktikë, Profeti ynë i dashur dha shembull për sahabët me praktikat e tij.

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s) u ngjit në mimber, shqiptoi tekbir dhe filloi namazin. Ai e fal namazin me qëndrimin në këmbë, me ruku dhe sexhde në përputhje me tadil-i erkan. Pastaj zbriti nga mimberi dhe u drejtohet atyre që janë në xhami dhe u thotë: "O ju njerëz, këtë e kam bërë që të më ndiqni dhe të mësoni se si falem."[11]

Duke u pyetur se në cilat intervale kohore mund të falen pesë namazet ditore, Profeti ynë (a.s) i tha një sahabiu që të qëndronte me të për dy ditë. Ditën e parë e fali namazin sapo hyri koha. Ditën e dytë e shtyu namazin deri para se të dali koha. Në fund të dy ditëve pyeti se: "Ku është personi që më pyeti për kohët e namazit?" ndërsa shikonte përreth, dhe sahabiu i tha: "Jam unë, o i Dërguari i Allahut!". I Dërguari i Allahut (a.s.) tha: "Namazi falet ndërmjet këtyre dy kohëve që i shikove".[12]

Përsëri, Profeti mori mëndafshin në njërën dorë dhe arin në tjetrën, duke thënë: "Këto të dyja janë të ndaluara për burrat e ymetit tim; por është e lejuar për gratë e tij."[13] Tregon se ai hasi një të ri duke përcjellë dhentë rrugës dhe i tregoi se si t'i shoqëronte[14], sepse siç thamë edhe më lartë ai i kushtonte rëndësi metodës së demonstrimit në arsim. Metoda e demonstrimit ka gjithashtu një vend të domosdoshëm në një edukim të dhënë sipas parimit të veprimtarisë. Nëse mësuesi e bën këtë për të fituar një sjellje, do të ngjall interes tek nxënësi dhe do të sigurojë që mësimi të jetë i përhershëm. Sepse metoda e demonstrimit përfshin shumë organe shqisore në procesin mësimor.

Shkrimtari R. Şemin, i cili kritikon sistemin arsimor pasiv, tha: "Përgjithësisht, fëmijët që rriten në shkollë janë mësuar ose të binden si robër ose të komandojnë si absolutistë. Është e vështirë të shpëtosh fëmijët që janë mësuar të trajtohen si subjekte kur janë të vegjël."[15] Sipas Şemin, një fëmijë që rritet në këtë mënyrë do të përjetojë probleme orientimi në moshën



madhore. Edukatori i famshëm Froebel shprehet se fillimisht duhet të ngjallet një dëshirë që informacioni t'i jepet fëmijës. Ai thotë se njohuritë e mësuara pa dëshirë do të jenë të vështira për t'u tretur, si ushqimi i ngrënë pa oreks.[16]

I Dërguari i Allahut gjithashtu përdorte shpesh metodat e vendosjes së një dialogu të ndërsjellë dhe të pyetjeve në mënyrë që bashkëbiseduesi i tij të merrte pjesë aktive në procesin e mësimdhënies dhe edukimit.

Sipas asaj që transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a), një ditë Profeti (a.s) i pyeti sahabët: "A e dini se kush është i falimentuar?". Sahabët thanë: "Në sytë tanë i falimentuar është ai që nuk ka para", thanë. I Dërguari i Allahut (a.s) ju tha: "Vërtet, i falimentuari i ymetit tim është ai person i tillë që do të vijë në ditën e gjykimit me namaz, agjërim dhe zekat, mirëpo, ky person ka abuzuar me dikë, ka shpifur për dikë për tradhti bashkëshortore, ka ngrënë pasurinë e dikujt, ka derdhur gjak dhe ka rrahur dikë. Për këtë arsye, atij i ndahet shpërblimi i veprave të mira. Nëse të drejtat e tij si rob nuk mbarojnë, por veprat e tij të mira kanë përfunduar, ai do të ngarkohet me mëkatet e mbajtësve të së drejtës dhe pastaj do të hidhet në xhehenem."[17]

Si në këtë dhe në shumë shembuj të ngjashëm, Profeti ynë (a.s) jo vetëm që e përqendroi vëmendjen e sahabëve në këtë temë duke bërë pyetje, por gjithashtu u mundësoi atyre të përfshihen aktivisht në procesin e të mësuarit duke u kërkuar atyre t'i përgjigjen pyetjeve.

Sipas parimit të veprimtarisë, informacioni i mësuar nga individi duhet të ketë një efekt të përjetshëm dhe të ruajë vazhdimësinë e tij. Me këtë aspekt, parimi i hapjes na kujton kuptimin islam të edukimit se vazhdimësia, edhe pse pak, është e virtytshme. Përveç kësaj, ka disa ndjenja që i sjell njeriun adhurimi, të cilat përhapen në të gjithë jetën e individit. Për shembull, bamirësia dhe agjërimi janë akte adhurimi që kërkojnë ndjeshmëri. Nga ne pritet të kuptojmë gjendjen e vështirë të njerëzve të varfër dhe në nevojë përmes ndjeshmërisë. Megjithatë, këto ibadete mundësojnë edhe zhvillimin e ndjenjave si ndarja, bashkëpunimi, mëshira dhe vëllazëria. Këto ndjenja janë reale. Ato ndikojnë në tërë jetën e një personi dhe krijojnë një lidhje të fortë mes muslimanëve. Në këtë mënyrë, individi fiton ndjenja të mira që do t'i formojë sjelljet e tij gjatë gjithë jetës me këto lutje. Aftësia për të përgjithësuar dhe transferuar ndjenjat si mirësia, dhembshuria dhe vëllazëria në të gjithë jetën nga individi mund të konsiderohet si një dimension i parimit të veprimtarisë.

(Fund)

Basım Yayım, Stamboll 1997, fq. 147.
10. Mehmet Zeki Aydın, Din Öğretiminde Yöntemler, Nobel Yayınevi, Ankara 2004, fq. 54-57.
11. Buhari, Xhuma, 24 (H. No. 917).
12. Muslim, Mesaxhid, 31 (H. No. 176).
13. İbn-i Maxhe, Libas, 19 (H. No. 3595).
14. Ebu Davud, Tahare, 73 (H. No. 185).
15. Refia Şemin, Karakter Formasyonu, İstanbul Üniversitesi Edebiyat Fakültesi Yayınları, Stamboll 1976, fq. 58.
16. Refia Şemin, Karakter Formasyonu, İstanbul Üniversitesi Edebiyat Fakültesi Yayınları, Stamboll 1976, fq. 58.
17. Muslim, Birr, 15 (H. No. 59)


HZ. ADEMI, ALEJHI SELAM

Ai është babai i tërë njerëzimit dhe ai është i pari dhe më i hershmi njeri, që ka zbritur mbi sipërfaqen e tokës; dhe prej pasardhësve të tij janë tërë njerëzit. Allahu i Lartamdhëruar e krijoi vetë atë prej baltës dhe i fryu atij prej shpirtit të Tij: “Ai, i cili përsosi çdo gjë, që krijoi dhe e filloi krijimin e njeriut prej balte!” – (Kur’ani, Es-Sexhde: 7)

Pasi, që Allahu krijoi Ademin (a.s) ia mësoi atij emrat e secilit send, dhe këto sende ua shfaqi melekëve, e ata nuk ditën t’i njihnin dhe i tha Ademit, që tua tregojë atyre: “Dhe, Ai i mësoi Ademit tërë emrat, pastaj ato ia shfaqi melekëve dhe i tha: Më tregoni për emrat e tyre, nëse jeni të sinqertë? Thanë: I Lartmadhëruar je; ne nuk kemi dije, përveç çfarë na ke mësuar; me të vërtetë Ti je i Dijshëm, i Urtë. Tha: O Adem, tregojua emrat e tyre; dhe sapo ua tregoi emrat e tyre u tha: A nuk ju kam thënë, se unë e di të fshehtën e qiejve dhe të tokës, dhe e di çfarë shfaqni e çfarë mbani fshehtas?!” – (Kur’ani, El-Bekare: 31-33)

Pamja e njeriut nuk ka ndryshuar nga pamja e tij, në të cilin e ka krijuar Allahu, përveçse në përmasa dhe tiparet e fytyrës, e nuk ka evoluar kurrë njeriu, siç thotë Darvini, se njeriu ka ardhur si rezultat i evoluimit të kafshëve, që i kanë paraprirë ekzistencës së tij, si p.sh majmunëve, gorillave, bonobout, orangutangut dhe shimpanzesë. Ky është një gabim ordiner dhe as që ka ndonjë shenjë, as prej afër e as prej së largu, të ekzistencës së njeriut përpara Ademit, ku ai është i ri në tokë, nëse krahasohet me krijesat e tjera. Ndërsa, matjet gjeologjike të moshës së njeriut, ato nuk janë argument, dhe janë të përafërta, duke ditur se dridhjet (tërmetet e ndryshme) të tokës i zhvendosin kockat në shtresa të shkëmbinjve të vjetër; për këtë arsye nuk krahasohet mosha e kockave me moshën e shtresave të formuara, që mbajnë kocka të ndryshme. Sikur t’i ndiqnim gjurmën, të cilat ka lënë pas njeriu, ato do të na kishin treguar për kohën e saktë të ekzistencës së tij, sepse hulumtuesit kanë gjetur se gjurmët (zbulimet) egjiptiane, janë sendet më të vjetra, që ka lënë pas njeriu. Sepse, që nga fillimi i tij i parë ka lënë dëshmi dhe shenja, që tregojnë për ekzistencën e tij kudo që ka zënë vend apo ka udhëtuar. Ai, që nga koha e shkeljes në tokë, është njeri që flet dhe mëson: “Dhe, ia mësoi Ademit tërë emrat...”. – (Kur’ani, El-Bekare: 31-33)

Ademi, përveç faktit që është babai i njerëzimit, ai gjithashtu është edhe pejgamberi i parë. Ai ka qenë i mësuar folës, që ka pasur gjuhën e tij, me të cilën komunikonte dhe i njihte emrat dhe domethënien e tyre. Kush mendon, se njeriu i parë mbi tokë, është njeriu i shpellës, i cili jetoi si kafshët dhe nuk e njihte jetën qytetëse apo nuk e njihte zjarrin dhe përpunimet e përshtatshme për të, ai gabon. Për sa i përket banuesve të shpellave, të cilët nuk kanë njohur gjuhën dhe komunikimin, dhe të cilët kanë jetuar si kafshët, hanin mishin e gjallë, ata janë të cilët kanë devijuar më pas nga bashkësia njerëzore dhe janë përhapur nëpër tokë, ku ka ndikuar te ta, për shkak të humbjes së përbërësve të jetës fisnike dhe harresës së asaj, në të cilën ishin paraardhësit e tyre, duke jetuar jetën e kafshëve apo diçka të ngjashme me to.



Krijimi i Ademit (a.s) ka ardhur pas krijimit të qiejve, të tokës, të maleve, të deteve, të diellit, të hënës, të planetëve, të yjeve dhe të zbukurimit me to të qiejve. Kështu edhe xhindët, Allahu i krijoi në tokë dhe bënin fesad (shkatërrime) në të, derdhnin gjak, derisa melekët vinin, i dëbonin, i ndëshkonin dhe nganjëherë i izolonin në ndonjë ishull në det. Allahu deshi të krijojë mëkëmbësin e Tij në tokë dhe ua përmendi melekëve: “Kur Zoti yt u tha melekëve: Unë po bëj në tokë një mëkëmbës. Thanë: A po bën në të, atë që shkatërron në të dhe derdh gjak, ndërkohë ne të lavdërojmë me falënderimin Tënd, të madhërojmë Ty. Tha: Unë di, atë që ju nuk dini!” – (Kur’ani, El-Bekare: 30)

Kjo nuk është kundërshtim i melekëve të asaj, çfarë ka caktuar Allahu të bëjë, por shpjegim i tyre ndaj Allahut; Ti, o Zoti ynë, nëse dëshiron krijesa të Të adhurojnë, atëherë ne të adhurojmë Ty, prandaj përse po krijon krijesa, që bëjnë ashtu siç kanë bërë më përpara xhindët në tokë. Përgjigja e Allahu për ta ishte, se Unë di, atë që ju nuk e dini.

Melekët nuk e dinin, se prej këtij krijimi të ri, do të ketë Pejgamberë, shehida (dëshmorë), të përkushtuar, të sinqertë, evlia dhe të dashtur të Allahut të Madhëruar. Ademi (a.s) ishte njëri prej tyre; ku ai është i pari i Pejgamberëve dhe kur Allahu e krijoi Ademin (a.s) i urdhëroi melekët t’i bënin sexhde dhe melekët menjëherë iu bindën urdhrit të Allahu, e i ranë në sexhde Ademit (a.s). Kjo sexhde (përulje) nuk ishte sexhde adhurimi, por ajo ishte sexhde përshëndetjeje dhe nënshtrim ndaj urdhrit të Alalhut.

Por ai, i cili nuk bëri sexhde, ai ishte iblisi (shejtani), i cili refuzoi të bënte sexhde për Ademin dhe bëri krahasim e u mburr me faktin se, ai u krijuar nga zjarri, e si t’i bëjë sexhde dikujt, që është më poshtë se ai, që u krijua nga balta. Kështu që, u dëbua nga mëshira e Allahut, por si qe, që iblisi (shejtani) ishte në qiell dhe xhindët në tokë, sepse ai ishte prej xhindëve, dhe jo prej melekëve: “Dhe, kur i thamë melekëve bini në sexhde Ademit, e i ranë në sexhde, përveç iblisit (shejtanit), që ishte prej xhindëve e kundërshtoi urdhrin e Zotit të tij. A po e merrni atë dhe pasardhësit e tij, mbrojtës, pos Meje, ndërkohë që ata janë për ju armiq. Sa i keq është ky zëvendësim për zullumqarët!” – (Kur’ani, El-Kehf: 50)

Iblisi është më i madhi i shejtanëve dhe ai është prej xhindëve. Ka qenë adhurues i Allahut në tokë dhe prej adhurimit të tij, Allahu e nderoi, duke e ngritur lart te melekët në qiell. Kur u ndal prej bindjes ndaj Allahut dhe nënshtrimit ndaj urdhrit të Tij, për t’i bërë sexhde Ademit, e dëboi prej mëshirës së Allahut. Prej këtu buron edhe urrejtja, hasreti (smira) dhe armiqësia e tij ndaj Ademit (a.s), dhe iblisi i kërkoi Allahut t’i japë afat deri në ditën e kiametit: “Tha: O iblis, çfarë ke, që nuk je prej sexhdebërësve? Tha: Nuk kam për t’i bërë sexhde njeriut, që e krijove prej baltës së ngjizur. Tha: Dil prej tij, sepse je i dëbuar. E, mallkimi qoftë mbi ty deri në ditën e llogarisë. Tha: O Zot, më jep afat deri në ditën e ringjalljes. Tha: Ti do të jesh prej të afatuarve; deri në ditën e momentit të caktuar. Tha: O Zot, për shkak se më largove, do tua zbukuroj (gjynahet) në tokë dhe do t’i largoj ata të tërë; përveç robërit Tuaj prej tyre të sinqertë. Tha: Kjo është rruga Ime e drejtë. Për robërit e Mi, ti nuk ke asnjë fuqi, përveç atij, që të pason prej mohuesve (jobesimtarëve). Dhe, se xhehenemi do të jetë vendtakimi i të gjithë atyre. Ai do të ketë shtatë dyer, për çdo derë nga ata do të ketë një pjesë të caktuar!” – (Kur’ani, El-Hixhr: 32-44)

Menjëherë, Allahu i Lartmadhëruar ia bërë të qartë Ademit, se shejtani është armik i tij dhe i pasardhësve të tij pas tij. Kështu që, mos e lejo atë të të nxjerrë prej xhenetit, në të cilin je.

Allahu e urdhëroi Ademin (a.s) të mos hajë prej një pemë të caktuar dhe të hajë prej çdo peme tjetër në xhenet. Në këtë periudhë, Allahu krijoi Havanë për shkak të vetmisë së Ademit dhe që të prehet tek ajo. Ademi dhe Havaja qëndruan në xhenet, derisa iblisi (shejtani) i cyti dhe ata të dy hëngrën prej pemës, të cilën Allahu ua kishte ndaluar (bërë haram) për ta. Nuk është e vërtetë, se Havaja, ajo ishte e cila e nxiti Ademin të hajë prej pemës. Kështu mendojnë disa, veçanërisht burrat, se ajo është shkaku në dëshpërimin (mjerimin) e njerëzimit, sepse ajo ishte sebepi i daljes prej xhenetit: “Dhe i thamë: O Adem bano ti dhe gruaja jote në xhenet, hani prej tij duke u kënaqur kudo që të dëshironi dhe mos ju afroni kësaj peme, e të bëheni prej zullumqarëve. Shejtani i shtyu të bënin gjynah dhe i nxori të dy prej asaj, në të cilën ishin në të. U thamë: Zbritni, armiq të njëri-tjetrit, dhe ju në tokë do të vendoseni dhe do të keni furnizim deri në një kohë të caktuar!” – (Kur’ani, El-Bekare: 35-36)

Ndërsa, teksti i Teuratit thotë: ‘Gruaja pa, se shija e pemës është e mirë, ajo është bukuri për syrin dhe tërheqëse për shikimin. Ajo mori prej frutave të saj dhe i hëngri, e ia dha burrit të saj gjithashtu dhe ai hëngri me të!’.

Kjo nuk e mohon gjynahun e Ademit, sepse ai hëngri, ndërkohë që e dinte se, Allahu e kishte ndaluar prej ngrënies së saj. Gjithashtu, edhe shejtani iu betua të dyve se, nëse do të hanin prej pemës, ata të dy do të kishin diçka tjetër, do t’i bënte dy melekë ose do të ishin të përjetshëm: “Shejtani i cyti të dy, për t’iu zbuluar çfarë kishin të mbuluar prej avretit të tyre dhe u tha: Nuk ju ka ndaluar të dyve Zoti juaj prej kësaj peme, përveçse të jeni melekë ose të jeni prej të përjetshmëve. Dhe, iu betua: Me të vërtetë unë jam për ju prej këshilluesve!” – (Kur’ani, El-Araf: 20-21)

Nga këtu, erdhi urdhri i Allahut, që të dalin prej xhenetit dhe të zbresin në tokë. Vendi i zbritjes së Ademit dhe Havasë nuk dihet me siguri, por më së shumti, Ademi (a.s) ka zbritur në Indi dhe Havaja ka zbritur në gadishullin arabik, afër Xhides. Ademi vazhdoi duke e kërkuar Havanë, derisa u takuan në malin e Arafatit dhe për këtë arsye u quajt me këtë emër.

Përmasat e Ademit (a.s) kanë qenë të tilla, gjatësia 60 krahë, ndërsa gjerësia 7 krahë, ku Imam Ahmedi transmeton në Musnedin e tij nga Ebu Hurejra (r.a), se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Gjatësia e Ademit ka qenë gjashtëdhjetë krahë në shtatë krahë gjerësi!” dhe në një transmetim tjetër: “Allahu e krijoi Ademin dhe gjerësia e tij ishte gjashtëdhjetë krahë, e krijesat nuk kanë pushuar së zvogëluari, deri më tani!” – (Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)

Hafidh in Haxher (r.h) thotë në Fet’hul-Bari, se krijesat nuk janë ndalur duke u zvogëluar, deri më tani dhe se lindjet e çdo shekulli janë më të shkurtra në gjatësi se sa shekulli paraardhës. Një krah është i barabartë me 55-60 cm afërsisht dhe kështu që, gjatësia e Ademit (a.s) ka arritur në 37 metra dhe gjerësia e tij në 4 metra. Hulumtimet e reja shkencore vërtetojnë se, mes faktorëve trashëgues dhe mjedisit ka lidhje shumë të ndërlikuar, ku genet trashëgues luajnë rol në ndryshimin e gjatësisë së trupit të njeriut me rreth 80 %.

Gjithashtu, studimet tregojnë se zonat e ekspozuara ndaj varfërisë, kequshqyerjes, mungesës së shërbimeve mjekësore dhe luftërave të gjata sjellin detyrimisht vonesa në rritje. Po ashtu, studimet kanë vërtetuar se, gjithashtu gjatësia e trupit të njeriut në vendet evropiane është më e gjatë se gjatësia e trupit të njeriut në Azi dhe në disa vende të tjera të Afrikës. Ndërkohë, gjatësia e trupit të njeriut në malet e alpeve Dinarike, në juglindje të Evropës është më e gjata në botë, kur gjatësia mesatare është 185 cm për meshkujt dhe 170 cm për femrat. Kjo do të thotë se, gjatësia e njeriut rritet dhe zvogëlohet sipas mjedisit, ushqyerjes dhe faktorëve të tjerë.

Ademi (a.s) së pari solli në jetë Kabilin dhe Habilin, dhe këta të dy ishin dy fëmijët e parë të tij. Mes të dyve ndodhi kontradiktë dhe konflikt, që lindi nga pakënaqësia e vëllait të madh, Kabilit për martesën e vëllait të tij të vogël, Habilit, për shkak të mospëlqimit të tij me bukurinë e saj dhe dëshirën e tij në martesë me binjaken e tij të bukur. Komentuesit (mufesirët) tregojnë se, Havaja sillte në jetë për çdo lindje dy binjakë, djalë e vajzë, dhe ishte e ndaluar (haram) martesa mes binjakëve të të njëjtës lindje. Kjo ka qenë në sheriatin e Ademit (a.s).

Të dy vëllezërit bënë nga një kurban për hir të Allahut për t’iu bërë e qartë secilit zgjidhja e kësaj çështjeje. Allahu pranoi kurbanin e Habilit, kështu që urrejtja e Kabilit për vëllanë e tij e shtiu të vriste vëllanë (Habilin): “Lexoju atyre lajmin e vërtetë të dy bijve të Ademit, që paraqitën kurbanë dhe u pranua nga njëri prej tyre dhe nuk u pranua nga tjetri. Tha: Patjetër, do të të vras! Tha: Me të vërtetë Allahu pranon prej të përkushtuarve. Nëse e shtrin dorën tënde për të më vrarë, unë nuk kam për ta shtrirë dorën time për të të vrarë ty; unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve. Unë dua, që të kthehesh me gjynahun tim dhe gjynahun tënd, e të jesh prej banorëve të zjarrit, dhe ky është shpërblimi i zullumqarëve. Egoja e tij ia zbukuroi vrasjen e vëllait të tij dhe e vrau, e u bë prej të humburve. Allahu dërgoi një sorrë, që gërmonte në tokë, për t’i treguar se si të mbulojë avretin (trupin e pambuluar) e të vëllait. Tha: O i mjeri unë, a u tregova i paaftë të jem si kjo sorrë, e t’i mbuloja avretin (trupin e pambuluar) e vëllait tim! E kështu u bë prej të dëshpëruarve!” – (Kur’ani, El-Maide: 27-31)

Ademi (a.s) jetoi njëmijë mijë vjet afërsisht dhe nuk dihet me siguri vendi i varrit të tij. Disa kanë thënë, se ai është varrosur në Indi, në vendin e zbritjes së tij ose në Mekë. Thuhet, se Nuhu (a.s) e ka mbartë atë dhe Havanë me tabut dhe i ka varrosur të dy në Bejtu-Makdis.

(Fb/ Hassan Mahmud)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

XHAMITË E SHKODRËS DHE FUNDI I TYRE GJATË PERIUDHËS SË SUNDIMIT TË EGËR KOMUNIST

Regjimi komunist gjatë gjithë kohës që sundoi në Shqipëri e luftoi fenë dhe traditat fetare. Lufta nisi qysh ditët e para kur e morën pushtetin komunistët dhe deri në ditën kur e dorëzuan.

Prishja e xhamive dhe ndryshimi i destinacionit të këtyre objekteve të shenjta ka qenë pjesë e kësaj lufte. Një kampion i tillë mund të studiohet në qytetin e Shkodrës, i cili ka qenë një nga qytetet ndër më të pasurat me objekte kulti myslimane.

Nga 39 të listuara më poshtë 30 xhami dhe shumë varreza u shkatërruan krejtësisht, duke ndryshuar paraqitjen urbanistike të qytetit. Gjëja e parë që u bë në vitin 1967 ishte rrëzimi i minareve dhe kthimi i këtyre objekteve në destinacione të tjera, si salla mbledhjesh për Frontin Popullor, sallë kinemaje, teatër, zyra për pushtetin lokal, magazina, depo, oficina etj.

Më pas këto objekte kulti së bashku me disa varreza u shkatërruan e u rrafshuan për t'i zhdukur nga kujtesa kolektive e popullit, si dhe për të ndryshuar konfiguracionin vizual urbanistik të këtij qyteti të lashtë duke i dhënë një pamje të re socialiste. Tre xhami u prishën së bashku me Pazarin e Vjetër të Shkodrës me vendosjen e Çamëve në ambientet e Pazarit, në vitet 1945-1946, me Bezistanin, që së bashku përbëjnë një nga humbjet më të mëdha të këtij qyteti për historinë dhe traditat e tij. 7 të tjera u prishën para ndalimit të fesë me ligj në vitin 1967, duke shkuar në 10 numri i xhamive të prishura brenda periudhës 1944-1967.

Kështu 1/3 e atyre të prishura dhe që iu është ndryshuar destinacioni i përket kësaj periudhe, ndërsa 2/3 janë prishur pas ndalimit të fesë me ligj. Për t'u vërejtur është se të gjitha këto xhami që përmenden më poshtë i përkasin të gjitha trashëgimisë osmane, me përjashtim të Xhamisë së Parrucës, e cila u prish dhe u rindërtua nga tregtarët dhe populli i Shkodrës në vitin 1936.

1. Xhamia e lagjes Bahçallëk me vlera të mëdha historike në vitin 1967 u kthye në oficinë për riparimin e automjeteve ushtarake, dhe më 1979 u prish përfundimisht nga tërmeti. (f. 116)

2. Xhamia e lagjes Alibegaj degradon dhe shkatërrohet nga ujërat e lumit Drin në vitin 1930. (f. 122)

3. Xhamia e Fatihut në kalanë e Shkodrës e rrënuar pjesërisht dhe e dalë jashtë funksionit. (f. 125)

4. Xhamia e Haxhi Mustafës në lagjen Tabake degradon dhe rrënohet në vitin 1925. (f. 126)

5. Xhamia e Plumbit në lagjen Tabake është edhe sot.

6. Xhamia e Lohjanëve e prishur nga lumi Drin 1858. (f. 134)

7. **Xhamia e Oxhakut** në lagjen Tabake e prishur nga ujërat e Kirit dhe Drinit 1838. (f. 135)

8. Xhamia e Haxhi Resulit e lagjes Qafë u shkatërrua krejtësisht në vitin 1967. (f. 136)

9. Xhamia e lagjes Ajasëm u riparua për herë të fundit më 1948 dhe më pas u la të degradojë për mungesë fondesh dhe prishet përfundimisht më 1967. (f. 138)

10. Xhamia e Karahysenit pas vitit 1967 kësaj xhamie i prishet minarja dhe u përdor si depo për tharjen e peshkut, dhe me prishjen e Pazarit të Vjetër zhduket përfundimisht edhe gjurma e fundit të kësaj xhamie. (f. 144)


11. Xhamia e Hynqarit –Selvisë kthehet në kopsht fëmijësh më 1967 dhe i prishet minarja, ndërsa me prishjen e Pazarit të Vjetër shkatërrohet plotësisht. (f. 153)

12. Xhamia e Sulejman Pashës u prish me shkatërrimin e Pazarit të Vjetër. (f. 159)

13. Xhamia e Mehmet Pashë Plakut e Medresesë u prish me prishjen e Pazarit të Vjetër nga regjimi komunist. (f.162)

14. Xhamia e Urës së Bunës u prish në vitin 1967. (f. 164)

15. Xhamia e shatërvanit të Teqes gjurmët e fundit të saj zhduken me prishjen e Pazarit të Vjetër të Shkodrës. (f. 166)





16. Mesxhidi i sheshit të Teqes shkatërrohet me prishjen e Pazarit të Vjetër të Shkodrës. (f. 171)

17. Xhamia Jugu Mëhallë e lagjes Liria pas vitit 1967 u kthye në shtëpi banimi. (f. 176)

18. Xhamia e Sheh Muhametit lagjja Karahasej u shkatërrua në vitin 1936. (f. 178)

19. Xhamia e lagjes Luguçezme u la të degradohej për mungesë fondesh dhe u prish në vitin 1950. (f. 183)

20. Xhamia e Haxhi Bajramit (sot aty është ndërtuar xhamia e Medresesë) në Xhabie në vitin 1967 u kthye në magazinë dhe më vonë u shkatërrua fare. (f. 188)

21. Xhamia e Bardhë Perash prishet në vitin 1962 për t'i lënë vend oborrit të shkollës Ali Laçej. (f. 192)

22. Xhamia e Kuqe në Perash i prishet minarja në vitin 1967 dhe kthehet në magazinë, ndërsa në vitin 1980 rrafshohet së bashku me varrezat. (f. 198)

23. Xhamia e lagjes Draçin në vitin 1956 kthehet në magazinë sherbele. (f. 210)

24. Xhamia e lagjes Tepe në vitin 1967 kthehet në sallë mbledhjesh për Frontin Popullor të lagjes duke iu prishur minarja dhe më 1970 prishet krejtësisht së bashku me varrezat. (f. 215)

25. Xhamia e Haxhi Koplikut rreth vitit 1964 shkatërrohet së bashku me varrezat për t'u ndërtuar më pas pallate banimi. (f. 218)

26. Xhamia e Parrucës në qendër të qytetit u prish në vitin 1967 dhe u rrafshua së bashku me varrezat. (f. 228)

27. Xhamia e Fushë Çelës (sot aty është ndërtuar xhamia "Ebu Bekër") u prish në vitin 1963 me arsyetimin "për nevoja urbanistike" dhe aty u vendos një lapidar i Luftës Nacional-çlirimtare. (f. 238)

28. Xhamia e Tophanës i prishet minarja më 1967 dhe kthehet në magazinë, pas një farë kohe shkatërrohet krejtësisht. (f. 251)

29. Xhamia e Garucit në vitin 1967 i prishet minarja dhe ambientet përshtaten për depo, e më pas për shtëpi banimi. (f. 262)

30. Xhamia Plakë i prishet minarja më 1967 dhe kthehet në magazinë, e më pas prishet krejtësisht dhe aty ndërtohet një pallat banimi 5-kate. (f. 269)

31. Xhamia e Begos prishet në vitin 1956 dhe në vend të saj ndërtohet Teatri Migjeni. (f. 279)

32. Xhamia në lagjen Rus i Vogël i prishet minarja në vitin 1967 dhe kthehet në sallë kinemaje, depo drithi, e më pas prishet fare, e aty ndërtohet një çerdhe fëmijësh. (f. 282)

33. Xhamia në Rus-Maxhar në vitin 1967 i prishet minarja dhe më pas shkatërrohet fare për t'u ndërtuar aty pallate banimi. (f. 301)

34. Xhamia e Shaban Efendisë (sot aty është ndërtuar xhamia e "Dy Vajzave") nga viti 1950 lihet pa u vënë dorë dhe degradon si ndërtesë, materialet e saj shiten dhe në vend të saj në vitin 1964 ndërtohet një repart i Ndërmarrjes së Zukth-Kashtës. (f. 308)

35. Xhamia e Mëhallës së Re u prish gjatë periudhës së komunismit. (f. 316)

36. Xhamia e lagjes Ndocej i prishet minarja në vitin 1967 dhe kthehet në magazinë libri, më pas prishet krejt, si dhe rrafshohen varrezat pranë saj. (f. 318)

37. Xhamia Dudas u shkatërrua krejtësisht në vitin 1968. (f. 328)

38. Xhamia e Kirasit në vitin 1967 iu prish minarja dhe u përshtat për zyrat e pushtetit lokal. (f. 340)

39. Xhamia e Dërgutit në vitin 1967 iu rrëzua minarja dhe u përdor për punë të ndryshme, pastaj degradoi dhe u shkatërrua krejtësisht. (f. 348)

*(Marrë nga libri: Institucionet Islame dhe hoxhallarët e Shkodrës, të autorit **Smajl Bala**)*



Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917–1996)

EMETA E STUDIMIT TË HISTORISË ËSHTË SE NE NGANJËHERË I SHFLETOJMË FAQET E SAJ PËR TË LEXUAR LAJMET E FITOREVE DHE TË DISFATAVE DHE LAJMET E LINDJEVE DHE TË VDEKJEVE;

POR, HISTORIA ËSHTË DIÇKA TJETËR PAS KËSAJ QË DUKET, AJO ËSHTË TË NJOHËSH SHKAQET PARAPRAKE, TË CILAT JANË RENDITUR DERI SA KANË ÇUAR NË FITORE APO NË DISFATË!

JUNNAN
PROVINCË E REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS

Junnan (Yunnan) është një provincë në jugperëndim të Kinës, pa dalje në det, dhe kufizohet me provincat kineze Guizhou dhe Siçuan (Sichuan), me rajonet autonome Guangshi (Guangxi) dhe Tibet, si dhe me vendet e Azisë Juglindore: Vietnamin, Laosin dhe Mianmarin.

Provinca ka një sipërfaqe afërsisht 436,200 km^2, dhe një popullsi prej 48.3 milion banorësh (viti 2018).

Kryeqyteti i provincës është **Kunming**.

GJEOGRAFIA

Junnan është provinca më jugperëndimore e Kinës. Terreni i Junnan-it është kryesisht malor, veçanërisht në veri dhe në perëndim. Një seri vargmalesh të larta janë të shpërndara në të gjithë provincën. Pjesa perëndimore e provincës ka terren kanionik, kurse pjesa veriore është pjesë e rrafshnaltës Junnan-Guizhou. Lumenjtë kryesorë të Junnan-it rrjedhin nëpër luginat e thella midis maleve.

Lartësia mesatare e provincës është 1,980 m mbi nivelin e detit. Malet janë më të larta në veri ku arrijnë më shumë se 5,000 m lartësi, kurse në jug ato janë jo më shumë se 3,000 m. Pika më e lartë në veri është maja Kauagebo, e cila është rreth 6,740 m mbi nivelin e detit, dhe më e ulëta është në Luginën e Lumit të Kuq në Qarkun Hekou, pranë kufirit me Vietnamin, me një lartësi prej 76.4 m.

Pjesa lindore e provincës është një pllajë gëlqerore me pamje karstike dhe me lumenj të palundrueshëm, që rrjedhin nëpër gryka të thella malore. Pjesa perëndimore karakterizohet nga vargmalet dhe lumenjtë që rrjedhin nga veriu dhe jugu. Këtu përfshihen lumenjtë Nu Xhiang, Lancang dhe Xhinsha, të cilët rrjedhin shumë afër njëri tjetrit në zonën e mbrojtur të “Tre Lumenjve Paralelë”. Terreni i thyer dhe vertikal prodhon një gamë të gjerë flore dhe faune, dhe rajoni është quajtur një kopsht natyror zoologjik dhe botanik.

Në Junnan gjenden një numër liqenesh ku nëntë prej tyre kanë një sipërfaqe më të madhe se 30 km2, si liqenet Lugu, Diançi , Fuxian, Xingiun, etj.

KLIMA

Pavarësisht se gjendet në tropikun e veriut, rajoni i rrafshnaltës lindore të Junnanit shquhet për temperatura të moderuara. Për shkak të lartësisë së madhe, verat janë të freskëta dhe dimrat të butë. Temperatura mesatare qershor-korrik është 22 °C, dhe temperatura mesatare dhjetor-janar 9 °C.

Në rajonin e kanionit perëndimor, malet e larta dhe luginat e thella krijojnë zona klimatike vertikale. Në fund të luginave mbizotëron nxehtësia e fortë me lagështi të lartë. Lartësitë 1,830 - 3,350 metra karakterizohen nga klima e butë, kurse majat e maleve mbështillen nga erërat e acarta.

Nën ndikimin e erërave musone që bartin shi dhe që fryjnë nga oqeani Paqësor dhe Indian, Junnani gëzon



reshje të mira kryesisht të shiut. Pjesa më e madhe e shiut bie nga maji deri në tetor, ku më shumë reshje bien në rajonin e kanionit perëndimor sesa në rajonin e pllajës lindore. Reshjet mesatare vjetore në Kunming (kryeqyteti, që gjendet në anën lindore të provincës) janë rreth 1,245 mm, ndërsa në Tengchong (në Junnanin perëndimor) janë rreth 1,475 mm.

EKONOMIA

Megjithëse vetëm rreth 6 % e tokës së Junnan-it është e punueshme, variacionet e gjera klimatike i sigurojnë provincës kultivimin e një shumëllojshmërie kulturash. Orizi është deri tani drithi ushqimor bazë, më i rëndësishmi i kultivuar në Junnan. Në fushat malore, në luginat e hapura dhe në faqet e kodrave me tarraca, orizi është kultura kryesore rreth një të katërtën e sipërfaqes së Junnan-it dhe është ndër rezervuarët më të mëdhenj drusorë në Kinë.

Provinca ka disa nga depozitat më të mëdha të kallajit në botë. Kallaji nxirret në pjesën juglindore të provincës dhe në perëndim të lumit Lancang. Junnan-i është gjithashtu një prodhues i madh i bakrit (i cili nxirret kryesisht në rajonin Huizi), plumbit dhe zinkut (në Lanping, në Junnanin perëndimor). Provinca Junnan ka depozita të moderuara të qymyrit dhe hekurit. Përveç kësaj, disa rezerva nafte dhe gazi natyror janë zbuluar në zona të caktuara në pjesët jugperëndimore dhe lindore të provincës. Produkte të tjera minerale përfshijnë antimonin, tungstenin, merkurin, fosforin, argjendin, arin aluvial, kinabarin (xeheror i merkurit) dhe manganin.

Prodhimi i energjisë elektrike është gjithashtu një komponent i rëndësishëm i ekonomisë së provincës. Energjia prodhohet nga termocentralet dhe, gjithnjë e më shumë, nga hidrocentralet. Provinca Junnan prodhon energji elektrike të tepërt, e cila eksportohet në provincat fqinje.

Pas vitit 1949 Junnan-i përjetoi rritje të konsiderueshme industriale. Zona Kunming është zhvilluar në një kompleks industrial gjigant i përbërë nga mullinj çeliku, objekte të shkrirjes së hekurit dhe bakrit, si dhe fabrika që prodhojnë plehra, makineri, kamionë, automobila, kimikate industriale, instrumente optike, tekstile dhe ushqime të përpunuara.



GJUHA

Gjuha zyrtare e Junnan-it është kinezishtja standarde.

Junnan-i është shtëpia e shumë grupeve minoritare, të cilët kanë secili gjuhën e tyre të ndryshme, prandaj konsiderohet si shtëpia e një morie dialektesh, që rrjedhin nga familjet e gjuhëve kineze, tibetiane dhe tajlandeze.

Qytetet lokale kanë shpesh versionin e tyre të gjuhës Mandarin, të cilat janë nën-dialekte të dialektit jugperëndimor të Mandarinit të përbashkët që flitet në Junnan, Guizhou dhe Siçuan. Pavarësisht theksit të rëndë, dialekti lokal i gjuhës kineze është shumë i ngjashëm me Mandarinin Verior, me shumë pak dallime të vogla rajonale në gramatikë dhe shqiptim.

FEJA

Sipas një analize demografike të feve në Junnan (të bërë në vitin 2005), pothuajse 90% e popullsisë nuk ndjekin asnjë besim fetar, 6% e popullsisë së përgjithshme janë budistë, 1.4 % janë muslimanë, 1.2% protestantë, 0.5% taoistë, 0.1% katolikë, etj.

Kurse sipas statistikave të regjistrimit të gjashtë, të bërë në vitin 2010, Junnan-i ka një popullsi muslimane prej 1.09 milionë banorësh, dhe më shumë se 867 xhami janë të shpërndara në të gjithë provincën.

HISTORI

Në antikitet, Junnan-i banohej nga grupe indigjene që nuk ishin pjesë e qytetërimit kinez Han. Ata ranë nën sundimin kinez vetëm në kohën e dinastive Kin (221–207 p.e.s) dhe Han. Edhe pas kësaj, pushteti qeveritar mbeti në duart e krerëve të fiseve, dhe kolonët kinezë depërtuan vetëm në pjesët lindore të provincës. Në vitin 109 p.e.s në atë rajon hanët kinezë krijuan prefekturën Jizhou. Nën dinastinë Tang (618–907 e.j) në rajonin Dali lulëzoi mbretëria Dai, e njohur si Nanzhao. E krijuar fillimisht si një mburojë kundër depërtimeve tibetiane, mbretëria Nanzhao u bë një kërcënim për fuqinë kineze, por gjatë periudhës së Pesë Dinastive (907-960) dhe dinastisë Song (960-1279), ajo ra përfundimisht.

Gjatë dinastisë Juan (mongole, vitet 1206–1368), situata e rajonit ndryshoi. Në vitin 1253 mongolët e shkatërruan përfundimisht mbretërinë Nanzhaon. Ata e emërtuan Junnan atë rajon, dhe e bënë atë një provincë të Kinës Juane, në vitin 1276. Për të ribanuar Junnan-in, i cili ishte shpopulluar nga lufta, guvernatori solli një numër të madh të etnisë Hui (myslimanë kinezë) nga Kina veriperëndimore. Pushtimi mongol e tërhoqi Junnan-in në orbitën e çështjeve kineze, por nuk arriti të zvogëlojë tensionin lokal ndëretnik midis pakicave Han dhe jo-Han.

Sundimtarët e dinastisë Ming (1368-1644), duke kërkuar të forcojnë kontrollin e tyre mbi provincë, përdorën njësi ushtarake për të nxitur migrimin e popullit kinez nga lugina e lumit Jangtze për në Junnan. Provinca qeverisej nëpërmjet një sistemi ‘tusi’ të trashëguar - që do të thotë: udhëheqës lokalë që shërbenin si agjentë të magjistratëve kinezë. Kjo politikë e sundimit indirekt vazhdoi edhe gjatë kohës së dinastisë King (1644–1911/12) dhe republikës (1911–49), kur u ndërmorën përpjekje për ta vënë provincën nën kontrollin e qeverisë qendrore më tërësisht.

Separatizmi rajonal i shoqëruar me dallimet etnike dhe fetare, e bënë Junnan-in një skenë të shpeshtë grindjesh. Në vitet 1674–78, Vu Sangui, i dërguar fillimisht nga qeveria King për të shtypur opozitën në Junnan, e përdori provincën si bazë për rebelimin kundër dinastisë King. Në vitet 1855–73, muslimanët, të udhëhequr nga Du Venxiu (i njohur si Sulltani Sulejman), morën armë nga autoritetet britanike në Burma (Mianmar) dhe organizuan rebelimin Pantaj, rebelim i cili u shtyp me një egërsi të madhe nga trupat perandorake kineze, të ndihmuara nga armët e marra nga autoritetet franceze në Tonkin (Veriu i Vietnamit). Në vitin 1915, Cai E, dikur guvernator i provincës, nisi në Junnan përpjekjen e tij për të mposhtur lëvizjen monarkiste të Juan Shikai, i cili ishte presidenti i republikës dhe po përpiqej të bëhej perandori i Kinës. Më pas, në dekadat mes Luftërave I dhe II Botërore, kryekomandantët Tang Xhijao dhe Long Jun e sunduan provincën si guvernatorë, duke e mbajtur atë jashtë kontrollit të qeverisë qendrore; ata nxitën kultivimin e lulekuqeve (për prodhimin e opiumit) dhe shkaktuan vuajtje të mëdha në popull për shkak të vënies së taksave të larta ndaj tyre.

SI ERDHI ISLAMI NË JUNNAN

Lidhur me epokën kur Islami u fut në Junnan, ekzistojnë dy teori: “teoria e hyrjes së Islamit atje gjatë dinastisë Tang”, dhe “teoria e prezantimit të Islamit atje gjatë dinastisë Juan (mongole)”. “Teoria e hyrjes së Islamit atje gjatë dinastisë Tang” është ende e vështirë për t’u verifikuar, për shkak të të dhënave të pamjaftueshme historike për këtë. Historianët përgjithësisht besojnë se në vitin 1253, Kublai Khan u urdhërua të sulmonte Junnan-in. Ai komandoi 100,000 trupa ushtarake elitare mongole në këtë betejë, dhe kjo ishte koha kur filloi hyrja e një numri të madh të popullsisë Hui (muslimane) në Junnan.

Në vitin 1274 e.j, Sai Diançi (Sej’jid Exhel Shems Ed-Din Omer El-Buhkari), një politikan i shquar musliman në

12

dinastinë Juan, u zgjodh nga Kublai Khan (perandori i dinastisë Juan), për të shërbyer si guvernator i provincës së Junnan-it. Si politikan dhe një musliman i shquar, Sai Diançi zbatoi një sërë masash politike, ekonomike dhe kulturore në Junnan, si krijimin e qeverisë rrugore, bashkimin e qeverisë, promovimin e ruajtjes së ujit, barazimin e taksave, ndërtimin e depove, hapjen e rrugëve postare, ndërtimin e xhamive dhe krijimin e shkollave falas. Në të njëjtën kohë, ai përhapi Islamin në Junnan.

Sipas legjendës, Sai Diançi themeloi 12 xhami në Shançan (Kunming-u i sotëm). Sipas "Junnan General Chronicles", xhamia Nançeng dhe Xhamia Jongning në Kunming, të dyja këto u ndërtuan nga Sai Diançi . Në vitin 1279, eksploratori italian Marko Polo, kur po udhëtonte në Junnan, ai pa se Kunming ishte: "Një qytet i madh dhe i shtrenjtë, me shumë tregtarë dhe punëtorë. Atje ka disa lloje njerëzish. Atje ka myslimanë, idhujtarë dhe disa të krishterë nestorianë". Marko Polo përmendi fillimisht se: "Atje ka muslimanë.", nga ku mund të konkludojmë numrin e madh të muslimanëve në Junnan gjatë Dinastisë Juan.

Gjatë kohës së dinastisë King, Islami në Junnan u integrua gradualisht me kulturën tradicionale kineze, duke filluar të formojë Islamin e Junnan-it, me karakteristika lokale multietnike. Manifestimet e tij ishin zhvillimi i arsimit dhe formimi i Shkollës së Junnan-it, shfaqja e klasikëve të përkthyer kinezë dhe prosperiteti i aktiviteteve akademike. Por, intensifikimi i diferencimit etnik, politikat e diskriminimit etnik të ndjekura nga qeveria King dhe shtypja që qeveria King i bëri kryengritjes së popullsisë Hui në Junnan (në fund të epokës së dinastisë), të gjitha këto e penguan zhvillimin e popullit Hui në Junnan, dhe zhvillimi i Islamit gjithashtu pësoi një goditje.

Në vitin 1872, pas dështimit të "Kryengritjes së popullsisë Hui" në Junnan, kjo popullsi u detyrua të fillonte aktivitete të mëdha migrimi. Ky zhvillim e intensifikoi shpërndarjen e muslimanëve në Junnan në shkallë të gjerë, në të gjithë vendin, duke krijuar kudo vendbanimeve të vogla të tyre. Me migrimin në shkallë të gjerë të popullsisë Hui, Islami u ruajt dhe u soll në të gjitha pjesët e provincës, madje edhe deri në Mianmar, në Siam-in (Tajlandë) ngjitur me Junnan-in, dhe në vende të tjera.

Gjatë Republikës së Kinës, Islami në Junnan filloi të lëvizte drejt një faze të re zhvillimi. Nga njëra anë, ai hyri në shoqëri dhe ishte i përkushtuar ndaj çlirimit kombëtar dhe revolucionit demokratik, dhe nga ana tjetër, zbatoi reformën fetare, themeloi grupe fetare, themeloi dhe botoi në mënyrë aktive gazeta dhe revista periodike, themeloi shkolla të reja dhe dërgoi jashtë shtetit studentë, të cilët krijuan një atmosferë të re dhe formë të re zhvillimi të kulturës islame në vend.

Pas themelimit të Kinës së Re, Qeveria Popullore garantoi lirinë e besimit fetar. Sipas statistikave, në vitin 1955, në provincën Junnan kishte më shumë se 490 xhami dhe më shumë se 1300 imamë. Por, gjatë "Revolucionit Kulturor", Islami në Junnan, si fetë e tjera, u dëmtua rëndë. Xhamitë u mbyllën, u tjetërsuan, ose u shkatërruan. Veprat klasike islame u dogjën dhe muslimanët u diskriminuan dhe u persekutuan.

Që nga viti 1978, qeveria kineze filloi politikën e lirisë së besimit fetar dhe Islami në Junnan hyri në rrugën e zhvillimit normal. Në vitin 1984 u krijua Shoqata Islame e Provincës Junnan. Në vitin 1987 u themelua Kolegji Islam i Kunming-ut. Deri më tani, Junnan-i ka rreth 1.6 milion qytetarë muslimanë (mund të jenë edhe më shumë, pasi statistikat nuk janë të sakta), 2.259 klerikë dhe 853 xhami. Shumë qendra islame janë hapur dhe restauruar, duke plotësuar kështu nevojat e muslimanëve për një jetë normale fetare. Më shumë se 8600 muslimanë nga Junnan-i kanë vizituar Arabinë Saudite, për pelegrinazhin e Haxhit, dhe 94 studiues të Islamit janë kthyer nga studimet jashtë vendit. Shumica e muslimanëve në Junnan janë patriotë dhe fetarë, dhe kontribuojnë për stabilitetin e kufijve të Junnan-it, për unitetin etnik dhe harmoninë fetare.


***

Së fundi, Islami në Kinë është vënë në shënjestër nga politikat e qeverisë. Partia ka mbyllur sistematikisht, shkatërruar ose ridizajnuar me forcë xhamitë në enklavat Hui, në të gjithë vendin, duke dënuar tiparet arkitekturore arabe, si kupolat dhe minaret, që sipas tyre janë provë e ndikimit të huaj të padëshiruar mbi Islamin në Kinë.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://en.wikipedia.org
https://www.britannica.com
http://www.norislam.com
https://u.osu.edu



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

Pesë namazet dhe xhumaja deri në xhuma janë shlyese (të gjynaheve) për ato që janë në mes tyre, nëse nuk kanë genë prej gjynaheve të mëdha!


(Transmetuar nga Muslimi)

NË KUJTIM TË MALCOLM X: TRASHËGIMIA E LUFTËS PËR DREJTËSI

Jeta, mësimet dhe inspirimi i Malcolm X vazhdon të jehojë në mbarë botën, gati gjashtë dekada pas vrasjes së tij.

Në një nga fjalimet e tij të fundit, të mbajtur vetëm pak ditë para vdekjes së tij, Malcolm X kishte thënë: "Më duhet të sqaroj pozicionin tim, i cili është i qartë. Unë nuk jam racist në asnjë lloj forme. Unë nuk besoj as edhe në asnjë formë racizmi. Unë nuk besoj në asnjë formë diskriminimi a ndarjeje. Unë besoj në Islam. Unë jam mysliman. Dhe nuk ka asgjë të keqe të jesh mysliman, asgjë të keqe me fenë islame. Thjesht na mëson të besojmë në Allahun si Zot." Pesëdhjetë e nëntë vjet më parë, më 21 shkurt 1965 shkëputjen e tij nga grupi në vitin 1964, pasi mendonte se Kombi kishte "arritur aq larg" për shkak të mësimeve të tyre të ashpra.

Kjo situatë çoi në acarim të gjerë. Ndërsa kërcënimet dhe presionet nga Kombi i Islamit kundër Malcolm X u përshkallëzuan, situata bëhej gjithnjë e më e paqëndrueshme. Kjo kulmoi me një incident të tmerrshëm kur një bombë djegëse u hodh në shtëpinë e tij rreth orës 3.30 të mëngjesit më 14 shkurt 1965.



Malcolm Little, i cili ende nuk kishte mbushur 40 vjeç, u vra, ndërsa ishte në podiumin e sallës së konferencave Audubon Ballroom në Harlem, ku ishte ngjitur për të mbajtur një fjalim për rreth 400 njerëz. Kur ai u qëllua, gruaja e tij, Betty Shabazz, ishte në sallë me katër vajzat e saj, më e madhja prej të cilave ishte 7 vjeç. Ajo gjithashtu, ishte shtatzënë me vajza binjake të cilat Malcolm X nuk do t'i shihte kurrë. Rrethanat rreth vrasjes së Malcolm X mbeten të mbuluara me mister.

Ndërsa nuk u vërtetua kurrë përfundimisht se kush ishte përgjegjës, ka pasur teori të vazhdueshme që sugjerojnë përfshirjen e anëtarëve të grupit Nation of Islam, si dhe spekulime rreth rolit të mundshëm të FBI-së.

Pasi iu bashkua grupit Kobmi Islami ndërsa ishte në burg në fund të viteve 1940, Malcolm X njoftoi publikisht

Malcolm X më vonë deklaroi se sulmi ishte orkestruar "me urdhër të Elijah Muhamedit", udhëheqësit të Kombit të Islamit, duke përshkallëzuar më tej tensionet midis Malcolm X dhe ish-organizatës së tij.

Malcolm X, i cili filloi të punonte me shkrimtarin Alex Haley në vitin 1963 për të shkruar autobiografinë e tij, kishte thënë: "Nëse ky libër botohet ndërsa unë jam ende gjallë, do të jetë një mrekulli". Disa muaj pas vdekjes së tij, Haley e përfundoi librin dhe e botoi atë si "Autobiografia e Malcolm X".

Libri, i cili shërbeu si burim për filmin "Malcolm X" me aktorin Denzel Washington, i cili fitoi çmime të ndryshme në vitin 1992, u emërua gjithashtu nga revista Time në 1998 si një nga "10 librat më me ndikim të shekullit XX".

(www.albanian.trtbalkan.com)



Malcolm X
(1925-1965)

"AMERIKA KA NEVOJË PËR TË KUPTUAR ISLAMIN, SEPSE AI ËSHTË FEJA E VETME, E CILA ZOTËRON ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË RACIZMIT.

GJATË UDHËTIMIT TIM NË BOTËN ISLAME, PASHË PËR HERË TË PARË NË JETËN TIME NJERËZ NGA ÇDO LLOJ NGJYRE, QË NUK SHIKONIN NGJYRAT E TYRE DHE JETONIN NË VËLLAZËRI TË VËRTETË.

AJO, QË PËRJETOVA NË ATË PARAJSË, MË NDRYSHOI IDETË E MIA!"

(I lindur si Malcolm Little, dhe më vonë i bërë, Malik El-Shabazz; 1925 – 1965)

NATA E MADHE E ISRASË DHE MIRAXHIT, SIMBOL I RIMËKËMBJES SË MADHE ISLAME!



Nata e Madhe e Israsë dhe Miraxhit, që përkon me datën 25 Rexheb 1445 | 6 shkurt 2024, është pa dyshim një moment reflektimi për të kuptuar forcën e besimit dhe mbështetjen e Allahut të Madhëruar në jetën e të Dërguarit të Tij, Hz. Muhammedit (a.s) dhe në marrëdhënie me çdo besimtar.

Është Nata e mrekullive të mëdha dhe të panumërta, nëpërmjet të cilave, para syve tanë shënohen disa momente kulminante, që na mbajnë të lidhur pas bindjes se çdo gjë në këtë është në dorën e Zotit Një; Ai është Mëshiruesi Mëshirëbërësi, që nuk e braktis besimtarin dhe që e lartëson atë, edhe nëse krejt bota ngrihen kundër tij.

Mesazhe të shumta, që i nevojiten besimtarëve, u dhanë nga ligjëratat dhe hytbet e kësaj jave, të xhumanë, më 2 shkurt 2024, në të gjitha xhamitë e Shkodrës.

Në xhaminë e Parrucës, imami i saj, H. Naim Drijaj dha mesazhe të rëndësishme që lidhen me edukimin e besimtarit dhe nxitjen e durimit dhe bindjes se Allahu nuk e braktis besimdrejtin e përkushtuar.


Nga hytbeja e xhumasë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, theksoi se është me rëndësi për rininë tonë të marrë bajrakun e Hz. Muhammedit (a.s), për të ecur përpara, si prijës të elitave, si dhe duke u distancuar nga thirrjet dhe propaganda e idhujtarisë moderne, imoralitetit e mosbesimit.

Në xhaminë "Ebu Bekër", imami i saj, H. Idmir Plaku, shpjegoi etapat e rëndësishme të ngjarjes së Israsë dhe Miraxhit, si mësime me dobi për jetën e besimtarëve.

Ndërkohë, nga minberi i xhamisë së "Dy Vajzave", imami i saj, H. Lavdrim Hamja, vuri theksin tek rëndësia e Mesxhidi Aksasë në jetën e muslimanëve, xhamia e shenjtë, që u zgjodh nga Krijuesi i gjithësisë si kible e parë për muslimanët dhe vendtakim i krejt të dërguarve të Allahut, përgjatë historisë së njerëzimit, nën drejtimin e Hz. Muhammedit (a.s).

Mesazhe të shumta u dhanë në këtë ditë të bekuar, sikurse u ftuan besimtarët drejt agjërimit, përsosjes së adhurimeve dhe lutjeve në këto ditë të begata të kësaj periudhe të bekuar në prag të Muajit Ramazan.





Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Adoni t'ju tregoj se me çfarë i fshin Allahu gabimet dhe i lartëson gradët"? Thanë: Po, si jo, o i Dërguar i Allahut! Tha: "Marrja abdes mirë kur përton dhe hapat e shpeshtë për në xhami; pritja e namazit pas namazit. Kjo është lidhja e fortë!

(Transmetuar nga Muslimi)

MYFTIU I SHKODRËS: "NATA E ISRASË DHE MIRAXHIT, REFLEKTIM DREJT RIMËKËMBJES!"



Me ftesë të Kryetarit të Mexhlisit të Bashkësisë Islame të Tuzit, në Mal të Zi, Hfz. Bajram Dizdarevic , Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në organizimet për nder të Natës së Madhe të Israsë dhe Miraxhit.

Në ligjëratën e tij, Myftiu Sytari u ndal tek mirësitë e mëdha dhe simbolikat e veçanta të kësaj mrekullie, nëpërmjet të cilës u forcua zemra e të Dërguarit të Allahut, Hz. Muhammedit (a.s) dhe u dëshmua botërisht madhështia e Vulës së të dërguarve, të cilët u falën nën drejtimin e Zotërisë së bijve të Ademit në xhaminë e shenjtë në Kudsi Sherifë.

Myftiu iu drejtua të rinjve të pranishëm që të djehen krenarë me Islamin e tyre, të ndjekin dritën e Resulullahut (a.s) dhe me dinjitet ta dëshmojnë veten, si elitë e vendit, në shërbim të paqes sociale, harmonisë dhe mbi të gjitha në drejtim të ruajtjes dhe forcimit të frymës së vëllazërisë islame dhe asaj kombëtare.

Aktiviteti u përshëndet nga Kryeimami i Tuzit, Islam ef. Pepiç, që uroi besimtarët me rastin e Natës së Madhe, sikurse shprehu kënaqësinë e tij për praninë e Myftiut të Shkodrës në mesin e besimtarëve në Tuz.

I pranishëm ishte edhe Atasheu i Ambasadës së Turkisë, dr. Bahatin Akbash.

Ndërkohë, ligjërata e Myftiut Sytari, u përkthye edhe në gjuhën boshnjake, nga Mr. Nadir Bajraktari.

Pas aktivitetit në xhami, bashkëbisedimi vazhdoi edhe në sallën e pritjes, me ç'rast u këmbyen edhe dhuratat e rastit.









Dr. Mustafa Mahmud
(1921-2009)

"Feja jonë nuk njeh këtë ndarje mes diturisë dhe besimit dhe ajo nuk plotësohet, veçse me të dyja.

Islami i vërtetë është dituri, punë dhe moral fisnik në krah të besimit në Allah, adhurimit dhe devotshmërisë ndaj Tij.

Kjo ana e diturisë (shkencës) në fe, kjo është ajo, që na mungon. Sepse, myslimanët, ata janë, të cilët meditojnë në krijimin e qiejve dhe tokës, ndërsa ne nuk meditojmë.

Ata janë, të cilët kërkojnë rritje në dituri (shkencë) për çdo ditë dhe thonë: "Dhe thuaj: O Zoti im, më shto dituri", ndërsa ne nuk kërkojmë rritje në dituri (shkencë) dhe as rritje në njohuri.

Për shkak të këtij boshllëku mendor dhe fetar kemi rënë në gracka të ideve të gabuara politike, të interpretimeve të gabuara politike dhe në rrjetën e thënies që është përhapur se ne jetojmë në një shoqëri injorante mosbesimtare!

Përshtati në shqip nga arabishtja:
Lavdrim Hamja

“ISRAJA DHE MIRAXHI” TRIBUNË FETARE ME XHAMITË E ZONËS SË BUSHATIT

Ditën e shtunë pasdreke, më 10 shkurt 2024, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare me rastin e Tre Muajve të Mirë: Rexheb, Shaban dhe Ramazan, kryesisht për Natën e Madhe të Israsë dhe Miraxhit me pjesëmarrjen e të gjitha xhamive të Zonës së Bushatit.



Krahas imamëve të xhamive Krye-Bushat, Barbullush, Shkjezë, Kosmaçë dhe Melgushë merrnin pjesë besimtarë të moshave të ndryshme si dhe nxënës të mejtepeve fetare.

Pas hapjes së këtij aktiviteti më lexim nga Kur‘ani Famëlartë, nga nxënësi i xhamisë Krye-Bushat, Erti Shima dhe fjalës prezantuese të programit, nga teologu Arben Halluni, u mbajtën dy kumtesa nga imamët e nderuar, H. Naim Drijaj dhe H. Sadri Ujka, të cilët folën rreth rëndësisë dhe dobisë së Natës së Madhe të Israsë dhe Miraxhit si dhe vlerës së sadakasë, bamirësisë në shërimin e varfërisë.

Në vijim të këtij aktiviteti, nxënës të mejtepeve paraqiten një program të shkurtër artistik me ilahi, recitime, salavate dhe dua-lutje.

Ndërsa në fund, aktivitetin e përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili në fjalën e tij ndër të tjera tha: “Aktiviteti i sotëm është një gjurmë e bardhë dhe një përpjekje e gjithë secilit prej nesh për me e dëshmu mrekullinë dhe mirësinë e besimit si dhe me dëshmu kënaqësinë në zemrat tona që sa herë që mblidhemi në shtëpitë e Zoti (xh.sh).

Sot, jemi mbledhur për të përkujtuar ngjarjen e Israsë dhe Miraxhit, mesazhet që dalin prej saj, por edhe për mësimet që nxjerrim nga kjo ngjarje e mrekullueshme dhe e jashtëzakonshme, me të cilën Allahu (xh.sh) e begatoi Pejgamberin tonë, Muhammedin (a.s)”.

Myftiu Sytari gjatë fjalës së tij kërkoi nga besimtarët që ngjarjen e Israsë dhe Miraxhit duhet ta përjetojmë gjatë përditshmërisë sonë për t’u dëshmuar e mira, për t’u dëshmuar pastërtia, ndershmëria, fjala e ëmbël, fytyra e qeshur, komunikimi i sinqertë dhe i paqtë me këdo për hir të Zotit Fuqiplotë.

Aktiviteti u përmbyll më një koktej dhe me një atmosferë të gëzueshme për të gjithë të pranishmit.







MYFTIU SYTARI LIGJËROI NË DISA XHAMI SHQIPTARE NË ZVICËR

Më ftesë të Xhamisë së Wilit në Zvicër dhe imamit të saj të nderuar, Mr. Bekim Alimi, gjatë datave 15-17 shkurt 2024, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në aktivitetet e zhvilluara nga komuniteti shqiptar në Zvicër, edhe me rastin e 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Fillimisht, ditën e xhuma, më 16/2/2024, Myftiu Sytari ligjëroi para hytbes së xhumasë, në xhaminë e Wilit, ku sipas programit, u përqendrua tek përgatitjet e besimtarëve në prag të Muajit Ramazan.

Ndërkohë, në darkë, ligjëroi në tribunën fetare të organizuar nga Xhamia Shqiptare në Salmsach në Romanshorn, ku hodhi dritë mbi cilësitë e besimtarëve në Kur’anin Famëlartë.

Ditën e shtunë, më 17/2/2024, Myftiu i Shkodrës ishte mik i Bashkësisë Islame Shqiptare “Hëna e Re” në Kreuzlingen, ku ligjlroi rreth tolerancës ndërfetare, si veçori e spikatur tek shqiptarët.

Poashtu, Myftiu mori pjesë edhe në organizimin vjetor të Xhamisë së Wilit, me rastin e pavarësisë së Kosovës, ku referoi rreth kontributit të hoxhallarëve shqiptarë për çështjen kombëtare.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu pati takime dhe bashkëbisedime vëllazërore me kolegët dhe vëllezërit e tij, Imam Bekim Alimi (Wil), Dr. Mixhit Osmani (Romanshorn), Mr. Rehan Neziri (Kreuzlingen), H. Enes Koshi (Wil), etj., me të cilët diskutoi për tematika të ndryshme me interes të përbashkët.













MYFTIU I SHKODRËS MORI PJESË NË PRITJEN E AMBASADËS SË KUVAJTIT

Mbrëmjen e së mërkurës, më 21 shkurt 2024, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasada e Shtetit të Kuvajtit në vendin tonë, me rastin e 63 vjetorit të Pavarësisë dhe 33 vjetorit të Çlirimit.







Me këtë rast, Myftiu Sytari uroi Ambasadorin e Kuvajtit në vendin tonë, Sh.T.Z. Faisal S. Al-Musaileem, duke e uruar për këto dy data të shënuara dhe duke dëshiruar mirëqenie dhe bekim për popullin vëlla kuvajtian.

Gjatë kësaj mbrëmjeje të shënuar, Myftiu takoi edhe shumë personalitete të huaja dhe të vendit, me të cilët ndau bashkëbisedime me dobi dhe mendime me vlerë me interes të përbashkët.

Myftinia Shkodër shpreh falënderimet e saj për kontributet e mëdha që Shteti i Kuvajtit ka dhënë për Shqipërinë dhe shqiptarët në kr

PROMOVOHET LIBRI ME DY VËLLIME “KËSHILLA MINBERI”



Pasditën e xhuma, më 23 shkurt 2024, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë Perash, promovimin e librit më dy vëllime “Këshilla Minberi”, me autor Adem Shahini, imam-hatib i xhamisë Perash.

Në këtë aktivitet morën pjesë Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari së bashku më stafin e tij, imamë, teologë, familjarë e të afërm të autorit, miq e dashamirë të librit, etj.

Fillimisht, fjalën e hapjes e mbajti teologu Arben Halluni, ku mes të tjerave tha se: Ky aktivitet që vjen në kuadër të Tre Muajve të Mirë, ka si qëllim të spikatë rëndësia e minberit të këshillave dhe mesazheve islame gjatë hytbeve të xhumasë si dhe për dobinë që sjellin ato tek besimtarët, të cilët i përkushtohen etikës së prezantimit, dëgjimit dhe respektit në përgjithësi të kësaj tribunë të vyer fetare.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari në fjalën e tij, pasi uroi dhe përgëzoi imamin e xhamisë së Perashit, H. Adem Shahni, theksoi se: “Autori përmes këtij botimi me dy vëllime jo vetëm që ka pasuruar bibliotekën e gjithsecilit me tema të dobishme, por ka sjell në vëmendje se sa rëndësi dhe vlerë ka minberi i hytbes, i cili është një nga simbolet e Islamit dhe mbi të gjitha trashëgimi e Pejgamberit tonë të dashur (a.s)”.



Një vështrim mbi librin dhe vlerat e tij, ishte referati i mbajtur nga imami i xhamisë së Dërgutit, Ensar Ismajlaj, i cili u ndal te rëndësia e librit, i cili sipas tij pasqyron tema të përzgjedhura të besimit, adhurimit, moralit, ngjarjeve të ndryshme islame, sipas kohës dhe situatave. H. Ismajlaj gjithashtu vuri në dukje edhe metodologjinë e autorit, mesazhet dhe konkluzionet që dalin nga secila temë dhe këshillë e minberit të hytbes së xhuma.

Me shumë kënaqësi, u prit fjala e autorit, Adem Shahini, i cili falënderoi Myftininë e Shkodrës dhe në veçanti Myftiun për organizmin e këtij promovimi, bashkëpunëtorët e tij që bënë të mundur daljen në dritë të këtyre botimeve si dhe familjen për përkrahjen dhe mëkimin e tyre për t’i shërbyer thirrjes islame me metodat më të mira të mundshme.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga prof. Ahmed Boriçi, i cili uroi autorin për botimin e këtyre dy librave dhe përfitimin që ai ka përjetuar edhe gjatë dëgjimit të këshillave në hytbet e ndryshme të ditëve të xhuma.

Në fund të aktivitetit, për pjesëmarrësit u shpërnda falas libri i ri i promovuar “Këshilla Minberi”.

MEJTEPI IM... XHAMIA TRUSH

Pak histori:

- Xhamia e fshatit Trush ndodhet në Njësinë Administrative Berdicë, Bashkia Shkodër.

- Aktualisht, fshati Trush përbëhet rreth 650 familje myslimane.

- Fiset më të njohura janë: Xhurreta, Ferracaku, Ramoshi, Tahirlanti, etj.

- Me ndryshimin e sistemit monist, në vitin 1990 me iniciativën e nismëtarëve të zonës, rimerret objekti i xhamisë së vjetër, ku pas pak viteve rindërtohet mbi themelet xhamisë së parë, me ato përmasa dhe me atë strukturë, duke e pajisur më gjërat e domosdoshme.



- Me kontributin financiar të Beqir Islam Mehasi, ish banor i këtij fshati me banim në ShBA, xhamisë i ndërtuan minaren.



- Ndërsa, në vitin 2014 ndërtohet xhamia e re madhështore me kontributin nga Turqia.

- Imamët e xhamisë Trush dhe njëkohësisht edhe mësues të mejtepeve që kanë shërbyer nga viti 2002 dhe në vazhdim janë: Nexhmi Guri dhe imami aktual Jetmir Braqi.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 22 mejtepe dhe kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në periudha të ndryshme nga viti 2002-2024 është mbi 800 nxënës.

Takimi me nxënësit:

Sektori i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, në vazhdën e takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi ditën e shtunë më 28 shkurt 2024 një takim me nxënësit e mejtepit/kursit fetarë të xhamisë Trush, me praninë e imamit dhe mësuesit z. Jetmir Braqi.

Drejtuesi i arsimit, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve në kursin veror intensiv, etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin, si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit, me krijesat e Zotit në tokë, etj.

Në fund, u zhvillua edhe një bashkëbisedim dhe pyetje-përgjigje rreth mësimeve që marrin nxënësit në këtë mejtep.



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË
MYFTINIA SHKODËR



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Nëse të gëzon e mira e bërë dhe të hidhëron e keqja e bërë, ti je besimtar!"

(Transmetuar nga Imam Ahmedi)

www.myftinia-shkoder.org

@Myftiniashkoder1990

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek